



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:167160

Datë: 30.03.2024

Numri i dokumentit: 05528917

KPPP.nr.1209/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit N.P.T “Beshi Com”, me adresë Magjistralja Ferizaj-Prishtinë, me NUI: 810670225, kundër debitorit “Lunari Company” Sh.P.K., me adresë në fshatin Komogllavë në Ferizaj, me NUI: 810186157, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.182/2022 të datës 27.05.2022, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Mubarak Shumolli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 15.03.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Lunari Company” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.182/2022 të datës 27.05.2022, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Mubarak Shumolli, dhe i njejti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përbaruesi Privat, me Urdhrin Përbarimor P.nr.182/2022 të datës 27.05.2022, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.21-SHV01-002-19, të datës 24.05.2021, me të cilin ka urdhëruar që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguajë kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 3,360.00 Euro, me kamatë ligjore 8 % deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e përbarimit, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbauesit Privat, debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbauesit, me arsyetimin se sipas praktikës afariste mes palëve obligimet e ndërsjella mes vete debitori dhe kreditori jo gjithëherë i kanë përmbushur me pagesën e faturave të caktuara dhe në afate strikte, por zakonisht barazimet financiare janë bërë për periudha të caktuara kohore, madje shpesh herë përmbushja e obligimeve të ndërsjella nuk është bërë me para të gatshme, por përmes kompensimit, kryesisht material. Më tej ka shtuar se edhe në rastin konkret, debitori dhe kreditori ishin dakorduar që faturën 21-SHV01-002-19 të datës 24.05.2021 debitori e ka kompensuar me faturën me nr.06/21 të datës 29.04.2021 përkatësisht në emër të borxhit të cilën e ka furnizuar me zhavor. I ka propozuar gjykatës që të miratohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për përmbauesit Privat. I ka kërkuar edhe shpenzimet për përpilimin e prapësimit dhe të gjitha shpenzimet tjera.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbauesi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbauesit po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbauesit paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbauesi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbauesit dokumentin e besueshëm faturën nr.21-SHV01-002-19, të datës 24.05.2021, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.21-SHV01-002-19 e datës 24.05.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njejta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1209/23, me datë 15.03.2024

G j y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.